



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 915/ 4 prot.

Datë 16/05/2022

V E N D I M
Nr. 475/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16/05/2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BOE “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-20775-02-28-2022, me objekt “*Marrëveshje kuadër me kohëzgjatje 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj: “ Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë*”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 289 674 042 (dy qind e tetëdhjetë e nëntë milion e gjashtë qind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyzet e dy) lekë pa TVSH ose 2,389,458.40 (dy milion e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katër qind e pesëdhjetë e tetë presje dyzet) EURO. (Kursi i këmbimit 121,23), **Loti 2** me Nr. REF-20782-02-28-2022, me objekt “*Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë, Njësia Administrative Horë- Vranisht dhe Lukovë*” me fond limit është 119 700 663 (një qind e nëntëmbëdhjetë milion e shtatë qind mijë e gjashtë qind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH ose 987,384.83 (nëntë qind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tre qind e tetëdhjetë e katër presje tetëdhjetë e tre) EURO. (Kursi i këmbimit 121,23), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.04.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-20775-02-28-2022, me objekt “Marrëveshje kuadër me kohëzgjatje 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj: “ Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 289 674 042 (dy qind e tetëdhjetë e nëntë milion e gjashtë qind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyzet e dy) lekë pa TVSH ose 2,389,458.40 (dy milion e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katër qind e pesëdhjetë e tetë presje dyzet) EURO. (Kursi i këmbimit 121,23), **Loti 2** me Nr. REF-20782-02-28-2022, me objekt “Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë, Njësia Administrative Horë- Vranisht dhe Lukovë” me fond limit është 119 700 663 (një qind e nëntëmbëdhjetë milion e shtatë qind mijë e gjashtë qind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH ose 987,384.83 (nëntë qind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tre qind e tetëdhjetë e katër presje tetëdhjetë e tre) EURO. (Kursi i këmbimit 121,23), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.04.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “A.E.K & CO” SHPK & “Pastrime Silvio” SHPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Ankimues:

Operatori ekonomik “BOE “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK
Adresa: Rruga “Asim Vokshi”, Pallati Alb Bulilding & 2T, Tiranë.

Operatori ekonomik “Rej” SHPK
Adresa: Zogu i Zi, Qatar Center, Kati 2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Himarë.
Adresa: Spile, Himarë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave

për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi ,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomik kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashut, KPP konstatoi se ankesat kanë lidhje me të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomik ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatorët ekonomikë “BOE “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK dhe “Rej” SHPK kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01-03-2022, është publikuar në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, SPE, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-20775-02-28-2022, me objekt “Marrëveshje kuadër me kohëzgjatje 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj: “Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës:

289 674 042 (dy qind e tetëdhjetë e nëntë milion e gjashtë qind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyzet e dy) lekë pa TVSH ose 2,389,458.40 (dy milion e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katër qind e pesëdhjetë e tetë presje dyzet) EURO. (Kursi i këmbimit 121,23), **Loti 2** me Nr. REF-20782-02-28-2022, me objekt “Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë, Njësia Administrative Horë- Vranisht dhe Lukovë” me fond limit është 119 700 663 (një qind e nëntëmbëdhjetë milion e shtatë qind mijë e gjashtë qind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH ose 987,384.83 (nëntë qind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tre qind e tetëdhjetë e katër presje tetëdhjetë e tre) EURO. (Kursi i këmbimit 121,23), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.04.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

II.2 Në datën 01.04.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 21.04.2022 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- “Rej” SHPK	102,869,017.67 lekë	skualifikuar
- “BOE “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK	106,640,592.78 lekë	skualifikuar
- BOE “Leka 2007 & Alpen Pulito” SHPK	108,686,445 lekë	skualifikuar
- BOE “AEK & CO & Pastrime Silvio” SHPK	115,591,569.65 lekë	kualifikuar
- “Fusha” SHPK	119,451,905.41 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 21.04.2022 operatori ekonomik “BOE “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D , skualifikohet nga pjesëmarrja në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë vijon:

- Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të ofertave ka konstatuar se oferta e paraqitur nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D përmban gabime aritmetike. Më datë 12.04.2022, autoritetit kontraktor i është drejtuar bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D me “ Kërkesë” në sistemin e prokurimeve elektronike , me anë të së cilës i ka bërë

të ditur konstatimin e gabimeve aritmetike në ofertë (bashkëlidhur tabela me të gjitha përlllogaritjet) dhe i ka kërkuar korigjimin e këtyre gabime. Nga afati i përcaktuar në kërkesë, deri më datën e vlerësimit përfundimtar të ofertave nga ana e ofertuesit nuk është pranuar korigjimi i gabimeve aritmetike (nuk ka dhënë asnjë përgjigje). Në këto kushte, bazuar në nenin 92, pika 2, të ligjit nr. 162/ 2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 3 të VKM-së nr.285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku parashikohet se ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi, komisioni i vlerësimit të ofertave vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D.

- Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të ofertave ka konstatuar se : “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I, në deklaratën e dates 01.04.2022 ka deklaruar si Drejtues Teknik z. E. T, për të cilin ka paraqitur edhe dokumentacionin shoqëruar: Diploma, Çertifikata, Libreze pune Kontratë pune. Në liçencën LN-1163-03-2016, me Kod III.2.B “Transportimi i mbetjeve të parrezikshme”, si Drejtues Teknik është z. E. K. Nga verifikimi i listëpagesave të paraqitura nga shoqëria “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj, për periudhën Gusht 2021 - Janar 2022, rezulton që z. E. K nuk është pjesë e punëmarrësve të deklaruar nga kjo shoqëri. Sipas ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ” të ndryshuar, dhe vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” ndër kriteret kryesore të plotësimit të kushteve për liçensim është Çertifikata e drejtuesit Teknik dhe Kontratë pune me Drejtuesin Teknik (me kohë të plotë pune). Bazuar në nenin 12 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, licenca/autorizimi/leja revokohet kur titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të. Fakti që drejtuesi Teknik nuk është i deklaruar në listëpagesa për një periudhë mbi 6 muaj, përmban shkelje të legjislacionit në fuqi: ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Nëse deklarimi nuk është bërë sepse punëmarrësi është larguar nga puna, atëherë kemi shkelje të legjislacionit në fuqi : Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ” të ndryshuar dhe vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, për rrjedhojë liçenca LN-1163-03-2016, me Kod III.2.B “Transportimi i mbetjeve të parrezikshme”, duhet të revokohet. Bazuar në nenin 77, pika 3, gërma “ a ” të ligjit nr. 162/ 2020 “Për prokurimin publik” , çdo operator ekonomik skualifikohet nga

pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është pale.

Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALKOIMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D.

- Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të ofertave ka konstatuar se : “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” me Nuis: K91628013D në deklaratën e dates 01.04.2022 ka deklaruar si Drejtues Teknik z. E. D.

Në liçecën LN-1293-10-2020, me Kod III.2.B “Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve të parrezikshme”, si Drejtues Teknik është Znj. E. Ç.

Nga verifikimi i listëpagesave të paraqitura nga shoqëria “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” , për periudhën Gusht 2021 - Janar 2022, rezulton që Znj. E. Ç, nuk është pjesë e punëmarrësve të deklaruar nga kjo shoqëri. Nga dokumentacioni i ngarkuar në sistem Znj. E. Ç është e punësuar si Drejtuese teknike pranë “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I. Në të njëjtë kohë Znj. E. Ç është Drejtuese Teknike në Liçencën NZ.6105/8 të ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj, si rrjedhojë nuk mundet të jetë e punësuar në një shoqëri tjetër ndërtimi sepse këto Veprime keto ne kundërshtim me VKM Nr.42,date 16.01.2008 « Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari «i ndyshuar Kreu IV pika 2 e tije «Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit. Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi...” Nga ekstrakti i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I, Znj. E. Ç është administratore e kesaj shoqërie që nga data 04/05/2020 deri më: 04/05/2025.

Sipas ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, dhe vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” ndër kriteret kryesore të plotësimit të kushteve për liçensim është Çertifikata e drejtuesit Teknik dhe Kontratë pune me Drejtuesin Teknik (me kohë të plotë pune). Bazuar në nenin 12 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, licenca/autorizimi/leja revokohet kur titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të.

Nëse deklarimi nuk është bërë sepse punëmarrësi është larguar nga puna, atëherë kemi shkelje të legjislacionit në fuqi : Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ” të ndryshuar dhe vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, për rrjedhojë liçenca LN-1163-03-2016, me Kod III.2.B “Transportimi i mjetëve të parrezikshme”, duhet të revokohet.

Bazuar në nenin 77, pika 3, gërma “ a ” të ligjit nr. 162/ 2020 “Për prokurimin publik” , çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është pale.

Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALKOIMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D.

- Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të ofertave ka konstatuar se:

Nga ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D, Znj. A F, është administratore e kesaj shoqërie që nga data 05/05/2020 deri më: 05/05/2025.

Fakti që Znj. A F nuk është e deklaruar në listëpagesa për një periudhë mbi 6 muaj, përmban shkelje të legjislacionit në fuqi: ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Bazuar në nenin 77, pika 3, gërma “ a ” të ligjit nr. 162/ 2020 “Për prokurimin publik” , çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është pale.

Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALKOIMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D.

- Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të ofertave ka konstatuar se : Formulari i Vetëdeklarimit të “ ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D, përban gabime sepse deklarimi fillon në emër të “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë

së huaj..... Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALKOIMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D.

II.5. Në datën 21.04.2022 operatori ekonomik “Rej” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

- Operatori ekonomik “ REJ “ SHPK me Nuis: Nuis: J93711608Q, nuk plotëson kriterin 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë: 1 (një) punonjës të licencuar si “Ekspert Dhënie e Ndhmës së Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- Licencë;

- CV-në përkatëse;

- Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

Znj.Ermira Xhaja disponon çertifikim vetëm për dhënien e ndihmës së pare, dhe jo për ndërhyrjen ndaj emergjencave.

- Operatori ekonomik “ REJ “ SHPK me Nuis: Nuis: J93711608Q, nuk plotëson kriterin 2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: k) Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 7-8 mije litra ujë, jo më pak se 1 (një) cope.

Autoboti AA865GC nuk është i pajisur me me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, sipas kërkesave të dokumenteve standarte të tenderit.

a) Makina me vinc për ngarkim-shkarkim kazanesh gjate levizjes dhe sharkimit ne vendet e perdorimit, jo më pak se 1 (nje) copë;

Automjeti me targa AB480CC, nuk është vinç për ngarkim-shkarkim kazanesh.

II.6. Në datën 27.04.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike, si dhe ka publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 56, me datë 04.05.2022 Njoftim Fituesin.

II.7. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 28.04.2022, operatori ekonomik ankimes BOE “Alko Impex General Construction” dshh &

“Alko Impex Construction” SHPK, ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij.

II.8. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 29.04.2022 në Sistemin e Ankesave Elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr.915/2022 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2150 e operatorit ekonomik Rej, ky operator ekonomik ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij dhe kualifikimin e ofertës së BOE “Pastrime Silvio” & “A.E.K & Co” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.9. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 891/3 prot., datë 29.04.2022, u publikuan kriteret e skualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimues BOE “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK pretendon se i plotëson.

II.10. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 915/2 prot., datë 04.05.2022, u publikuan kriteret e skualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimues “Rej” SHPK pretendon se i plotëson si dhe kriteret të cilat operatori ekonomik ankimues “Rej” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga BOE “Pastrime Silvio” SHPK & “A.E.K & Co” SHPK.

II.11. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 891/5, datë 09.05.2022, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues BOE “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK.

II.12. Me shkresën nr. 2076/6 prot., datën 12.05.2022, protokolluar me tonën me nr. 891/6 prot., datë 16.05.2022, me objekt “Kthim Përgjigje shkresës së KPP me nr 891/5 prot, datë 09.05.2022” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik BOE “Alko Impex General Construction” dshh &

“Alko Impex Construction” SHPK, në të cilën konstatohet, se me vendimin nr. 2076/3 prot datë 09.05.2022, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ka vendosur refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes BOE “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK.

II.13. Në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, me shkresën nr 891/4 prot, datë 04.05.2022 dhe me shkresën nr. 915/3 prot, datë 09.05.2022 pranë Komisionit Prokurimit Publik janë paraqitur argumente nga operatori ekonomik i interesuar BOE “Pastrime Silvio” & “A.E.K & Co” SHPK, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit paraprak të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik BOE “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen : “[...] Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të ofertave ka konstatuar se oferta e paraqitur nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D përmban gabime aritmetike. Më datë 12.04.2022, autoritetit kontraktor i është drejtuar bashkimit të operatorëve ekonomikë “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D me “ Kërkesë” në sistemin e prokurimeve elektronike , me anë të së cilës i ka bërë të ditur konstatimin e gabimeve aritmetike në ofertë (bashkëlidhur tabela me të gjitha përlllogaritjet) dhe i ka kërkuar korigjimin e këtyre gabime. Nga afati i përcaktuar në kërkesë, deri më datën e vlerësimit përfundimtar të ofertave nga ana e ofertuesit nuk është pranuar korigjimi i gabimeve aritmetike (nuk ka dhënë asnjë përgjigje). Në këto kushte, bazuar në nenin 92, pika 2, të ligjit nr. 162/ 2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 3 të VKM-së nr.285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku parashikohet se ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi, komisioni i vlerësimit të ofertave vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 2 “Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 2.

*(Shtojcë për t’u paraqitur nga
operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE TË
SHËRBIMEVE**

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe

tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet.

Shërbimetpa çmimdo të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

PREVENTIV PËRMBLEDHËS NJËSIA LUKOVË

NR	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJES IA	SASIA E PARASHIKU AR PER 12 MUAJ	CMI MI	VLE RA PER 12 MUAJ J	VLER A PER 36 MUAJ J

1	FSHIRJE ME FSHESE DORE E RRUGEVE DHE SHESHEVE(BORSH,PIQE RAS,L UKOVE,SHEN VASIL, NIVICE)	m2	401 69			
2	GRUMBULLIMI E TRANSPORTIMI I MBETURINAVE URBANE ME KONTENIERË E MJET TEKNOLOGJIK DERI NË VENDDEPOZITIMIN E MBETURINAVE.(STACIONI I TRANSFERIMIT VUMBLO) PER12 MUAJ	kazane	100			

3	GRUMBULLIMI E TRANSPORTIMI I MBETURINAVE URBANE ME KONTENIERË E MJET TEKNOLOGJIK DERI NË VENDDEPOZITIMIN E MBETURINAVE.(STACIONI I TRANSFERIMIT VUMBLO)SEZONI TURISTIK	kazane	75			
4	LARIA E KONTINIEREVE	dit/pun.	50			
5	LAGIJA E RRUGEVE DHE SHESHEVE ME MJET TEKNOLOGJIK (2HERE NEDITE)	m2	40 16 9			
6	HEQJA E MBETJEVE INERT EOLUMINOZE NGA PIKAT E GRUMBULLIMIT	dit/pun.	31 2			
7	GRUMBULLIMI E TRANSPORTIMI I MBETURINAVE NE	m2	29 30 35			

	PLAZHE					
8	EDUKIMI PUBLIC DHE AMBJENTAL I QYTETARËVE	muaj	12			
	SHUMA (1+2+3+4+5+6+7+8)					

PREVENTIV PËRMBLEDHËS NJËSIA HORË-VRANISHT

1	FSHIRJE ME FSHESE DORE E RRUGEVE DHE SHESHEVE(TERBAC, VRANISHT,BOLENE, KALLARAT, KUC)	M2	8689 8			
2	GRUMBULLIMI E TRANSPORTIMI I MBETURINAVEURBANE ME KONTENIERË E MJET TEKNOLOGJIK DERI NË VEND DEPOZITIMIN E MBETURINAVE.(STACION I I TRANSFERIMIT VUMBLO) PER 12MUAJ	KAZAN E	140			
3	LARIA E KONTINIEREVE	DIT/PU N.	50			
4	LAGIJA E RRUGEVE DHE SHESHEVE ME MJET TEKNOLOGJIK (2HERE NE DITE)	M2	3063 1			

5	HEQJA E MBETJEVE INERT EOLUMINOZE NGA PIKAT E GRUMBULLIMIT	DIT/PU N.	312			
6	EDUKIMI PUBLIC DHE AMBJENTAL I QYTETARËVE	MUAJ	12			

	SHUMA (1+2+3+4+5+6)					
	SHUMA A+B					
	TVSH 20%					
	SHUMA TOTALE					

Oferta e operatorit ekonomik duhet të shoqërohet me analizat përkatëse për çdo zë preventivi.

II.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë dorëzuar:

- Shtojca 2 “Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit së bashku me analizën e kostos”.

III.1.3. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.1.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

III.1.5. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.1.6. Në nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Në nenin 77, pikën 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.1.7. Në nenin 82, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“3.*

Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.

b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.

c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.”

III.1.8. Neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

- 1.Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.
- 2.Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.
- 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

III.1.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje

me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me dokumentat standarte të tenderit të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se shtojca 2 e dokumenteve të tenderit të hartuara nga autoriteti kontraktor, është hartuar në përputhje me shtojcën 2 të Dokumente Standarde të Tenderit të hartuara nga APP-ja dhe të publikuara në faqen zyrtare app.gov.al. Vlen të theksohet se, kërkesat e dokumenteve të tenderit duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen e ofertuesve të mundshëm në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

III.1.10. Në rastin konkret, nga verifikimi i preventivit të paraqitur nga ankimuesi, konstatohet se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij është bërë konform përcaktimit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, duke e shoqëruar këtë edhe me analizën e çmimeve përkatëse siç janë kërkuar në këto dokumente. Në dokumentet standarde të tenderit, është e përcaktuar në seksionin *I Udhëzime për operatorët ekonomikë gërma B. PËRGATITJA E OFERTAVE*, pika 4. “*Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqëruar duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar*”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se rastet e parashikuara në të cilën konstatohen gabime aritmetike *stricto sensu* shtrihen në vetëm dy drejtime; *së pari në rast se ka gabime të mundshme në rast të kryerjes së veprimeve matematikore të shumëzimit mes çmimit për njësi dhe në rast se ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave*. KPP gjykon se në konstatimin e gabimeve aritmetike, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në konstatimin e gabimeve të mundshme aritmetike duhet të kufizohet vetëm në dy rastet e sipërcituara në respekt të parashikimeve të lex specialis si edhe të aktit nënligjor në zbatim të ligjit. Racio e kufizimeve vetëm në rastet e sipërcituar lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me shmangien e ndryshimeve në ofertë e cila është e ndaluar nga ligji për prokurimin publik, në të cilin parashikohet se “*1. Pas paraqitjes së ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit kontraktor dhe ofertuesit për ofertën. Një ofertuesi, si kusht për*

shpalljen fitues, nuk duhet t'i kërkohej që të ndërmerret përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdo mënyre ofertën. Gjithashtu, në interpretim sistematik, domethënien e drejtë të normës juridike në lidhje me normat e tjera të sistemit, kufizimi në konstatimin e gabimeve aritmetike të ofertës ekonomike e cila në thelb paraqitet si një ndër garancitë që ofron kuadri ligjor mbi ndalimin e modifikimit të ofertës ekonomike, e cila shfaqet me një lidhje të drejtpërdrejtë me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit ato të transparencës dhe barazisë. Gjithashtu, në interpretim të parashikimeve të mësipërme akti nënligjor në zbatim të ligjit ka parashikuar dhe procedurën të cilët duhet të ndjekë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në rastet e konstatimit të gabimeve aritmetike ku ndër veprimet procedurale të kryera përfshihet njëherazi detyrimi ligjor për komunikim me ofertusin (si një ndër rastet përjashtimore të komunikimit midis KVO-së dhe operatorëve ekonomikë pjesëmarrës). Në rastin konkret, nga shqyrtimi, parashtrimeve me shkrim të ankimuesit prima facia Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor në arsyet e skualifikimit citohet se janë konstatuar gabime aritmetike por pa cilësuar sipas dy parashikimeve si më sipër sqaruar, (nëse këto konstatime të gabimeve janë në kryerjen e veprimit matematikor të shumëzimit të çmimit për njësi dhe sasië dhe / ose gabime midis shumës në shifra dhe asaj në fjalë) dhe aq më tepër nëse gabimet aritmetike kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. Nisur nga sa më sipër lidhur me veprimet procedurale të autoritetit kontraktor në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, në të cilin parashikohet se “*1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre*”, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra, kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. KPP gjykon se KVO ka kryer veprimet procedurale të konstatimit të gabimit aritmetik të ofertës ekonomike dhe ka skualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomikë pa pritur sqarimet/aprovimet nga ana e operatorit ekonomik ankimues duke skualifikuar këtë të fundit, duke nxjerrë në thelb një akt i cili është në kundërshtim me formën e kërkuar nga ligji.

Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, nuk rezulton e provuar se vlera absolute e gabimeve aritmetike tejkalon masën prej 2% të vlerës ekonomike të ofertuar.

Në nenin 88 pika 3 të vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, parashikohet ndër të tjera se: Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë

apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

- a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.
- b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotalëve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.
- c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- **shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.**

Konkretisht, në rregullat e prokurimit publik është parashikuar se oferta me gabime aritmetike refuzohen kur shuma absolute e të gjithë korrigjimeve është më shumë se 2 % e vlerës ekonomike të ofertuar pa pritur shprehjen e vullnetit të operatorit ekonomik, ndërkohë që në rast se shuma e korrigjimeve është më pak se 2% oferta ekonomike me gabime aritmetike refuzohet vetëm kur korrigjimi nuk pranohet nga ofertuesi. Në rastin konkret, ligjvënësi parashikon një procedurë të posacme, atë të shprehjes së vullnetit të operatorit ekonomik. Gjithashtu, në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “ Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.” Sa më sipër, KPP konstaton se ligjvënësi nuk ka parashikuar një afat prekluziv, ligjor për shprehjen e vullnetit të operatorit ekonomik për pranimin ose jo të korrigjimeve të gabimeve të konstatuara nga autoriteti kontraktor, sikundër parashikohet në nenin 93 të ligjit për prokurimin publik, afati 3 ditor prekluziv i përgjigjes mbi arsyetimin e një oferte të dorëzuar anomalisht të ulët. Sa më sipër, KPP gjykon se fakti i mos kthimit të përgjigjes nuk përbën refuzim të operatorit ekonomik për pranimin ose jo të korrigjimit të gabimeve, për sa kohë që ky i fundit ka ushtruar mjetin e ankimit administrativ kundër vendimit të autoritetit kontraktor. Gjithashtu, edhe legjislacioni në fushën administrative dhe konkretisht, Kodi i Procedurave administrative nuk njeh në asnjë rast institutin e refuzimit në heshtje, por të kundërtën. Kjo, për vetë faktin se shprehja e vullnetit në një procedurë administrative është çdo sjellje objektive dhe e

qëllimtë që i drejtohet një personi fizik ose juridik palë në procesin administrativ në përputhje me parashikimet e K.Pr.A. Në rastin konkret, KPP gjykon se nga ana e autoritetit kontraktor skualifikimi i ofertës së operatorit ekonomik nuk është mbështetur në legjislacionin në fuqi, për sa kohë që së pari as ligji dhe as akti nënligjor nuk parashikon një afat prekluziv për pranimin ose jo të korigjimit të gabimit aritmetik dhe së dyti rregullat e prokurimit publik parashikojnë të drejtën e autoritetit kontraktor për refuzimin e ofertës vetëm në rast se vlera absolute e gabimeve aritmetike tejkalon 2 % të shumës së ofertuar, në të kundërt kërkohet shprehja e vullnetit të operatorit ekonomik, vullnet i cili është shprehur edhe me anë të mjetit të ankimit administrativ.

III.1.11. Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale, si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht nenin 124 “*Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” dhe nenin 36 “*Sigurimi i kontratës*”, dhe nenin 108 “*Raportimi në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale*” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 124 “*Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës*” të LPP, si dhe nenit 36 “*Sigurimi i kontratës*”, dhe nenit 108 “*Raportimi në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale*” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar. Bashkimi operatorëve ekonomikë ankimues “*Alko Impex General Construction*” dshh & “*Alko Impex Construction*” SHPK me anë të dokumentacionit të paraqitur, vërteton se plotëson me sukses kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues BOE “*Alko Impex General Construction*” dshh & “*Alko Impex Construction*” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues BOE “*Alko Impex General Construction*” dshh & “*Alko Impex Construction*” SHPK, mbi skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “*Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të ofertave ka konstatuar se : “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I, në deklaratën e dates 01.04.2022 ka deklaruar si Drejtues Teknik z. E. T, për të cilin ka paraqitur edhe dokumentacionin shoqërues: Diploma, Çertifikata, Librezë pune Kontratë pune. Në liçencën LN-1163-03-2016, me Kod III.2.B “Transportimi i mbetjeve të*

parrezikshme”, si Drejtues Teknik është z. E. K. Nga verifikimi i listëpagesave të paraqitura nga shoqëria “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj, për periudhën Gusht 2021 - Janar 2022, rezulton që Z.E. K nuk është pjesë e punëmarrësve të deklaruar nga kjo shoqëri. Ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ” të ndryshuar dhe vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, për rrjedhojë liçenca LN-1163-03-2016, me Kod III.2.B “Transportimi i mbetjeve të parrezikshme”, duhet të revokohet. Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të ofertave ka konstatuar se : “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” me Nuis: K91628013D në deklaratën e dates 01.04.2022 ka deklaruar si Drejtues Teknik z. E. D. Në liçecën LN-1293-10-2020, me Kod III.2.B “Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve të parrezikshme”, si Drejtues Teknik është Znj. E. Ç. Nga verifikimi i listëpagesave të paraqitura nga shoqëria “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” , për periudhën Gusht 2021 - Janar 2022, rezulton që Znj. E. Ç, nuk është pjesë e punëmarrësve të deklaruar nga kjo shoqëri. Nga dokumentacioni i ngarkuar në sistem Znj. E. Ç është e punësuar si Drejtuese teknike pranë “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I. Në të njëjtë kohë Znj. E. Ç është Drejtuese Teknike në Liçencën NZ.6105/8 të ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj, si rrjedhojë nuk mundet të jetë e punësuar në një shoqëri tjetër ndërtimi sepse këto Veprime keto ne kundërshtim me VKM Nr.42, date 16.01.2008 « Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari «i ndryshuar Kreu IV pika 2 e tije «Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit. Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi...” Nga ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I, Znj. E. Ç është administratore e kesaj shoqërie që nga data 04/05/2020 deri më: 04/05/2025. Sipas ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ” të ndryshuar, dhe vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” ndër kriteret kryesore të plotësimit të kushteve për liçensim është Çertifikata e drejtuesit Teknik dhe Kontratë pune me Drejtuesin Teknik (me kohë të plotë pune). Bazuar në nenin 12 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, licenca/autorizimi/leja revokohet kur titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të. Nëse deklarimi nuk është bërë sepse punëmarrësi është larguar nga puna, atëherë kemi shkelje të legjislacionit në fuqi: Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ” të ndryshuar dhe vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, për rrjedhojë liçenca LN-1163-03-2016, me Kod III.2.B “Transportimi i mbetjeve të parrezikshme”, duhet të revokohet. Bazuar në nenin 77, pika 3, gërma

“ a ” të ligjit nr. 162/ 2020 “Për prokurimin publik” , çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është pale. Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALKO IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pika 2.3.2 “Kapaciteti Teknik” në dokumentet standarde të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Liçencë të vlefshme të shoqërisë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) , Kategoria III.2 “ Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis “, Nënkatgoria III.2.B “Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane”.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik BOE “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Dokumenti “Kontratë bashkëpunimi”, datë 31.03.2022, ndërmjet operatorëve ekonomikë “Alko Impex General Construction” SHPK dhe “Alko Impex Construction” SHPK. Në këtë kontratë bashkëpunimi në nenin 4 të saj pika 1 “Pjesëmarrja”, është përcaktuar se: Pjesëmarrja e shoqërive e shprehur në përqindje në arritjen e objektit të kësaj kontrate do të jenë si më poshtë:
Loti 2: “Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë, Njësia Administrative Horë-Vranisht dhe Lukovë”
Shoqëria “Alko Impex General Construction” SHPK do të kontribuojë në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër 30 % të punimeve.
Shoqëria “Alko Impex Construction” SHPK do të kontribuojë në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër 70 % të punimeve.
2. Licencë me Kodin III.2.B (1) LN-1293-10-2020, “Alko Impex Construction” SHPK, me akt - miratimi Nr. 6758 prot, datë 12.10.2020, me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”.

3. Licencë me Kodin III.2.A (1) LN-2898-03-2017, “Alko Impex General Construction” SHPK, me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Veprimtari e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedisë (Auditim mjedisor, Ndikim në Mjedis).
4. Licencë me Kodin III.2.B (1) LN-1163-03-2016, “Alko Impex General Construction” SHPK, me akt - miratimi Nr. 1531 prot, datë 04.03.2016, me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”.

III.2.3. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.2.4. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:
1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.5. Në nenin 41 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë. për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.2.6. Neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

- 1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.
- 2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.
- 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

III.2.7. Në nenin 20 “Shqyrtimi dhe vendimmarrja për grupin e tretë”, seksioni 2 të ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht:

1. QKL-ja merr në shqyrtim paraprak, sipas pikës 1 të nenit 19 të këtij ligji, kërkesat për grupin e tretë, sipas radhës së paraqitjes së tyre.
2. QKL-ja vlerëson vetëm përmbushjen e kriterëve në kompetencë të saj, e bazuar në vetëdeklarimin e kërkuarit dhe/apo dokumentet provuese, sipas të njëjtave procedura dhe afate, sipas rastit, të përcaktuara për grupin e parë ose të dytë. Vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të tjera të licencimit/autorizimit/lejes bëhet sipas pikave 4 e 5 të këtij neni.
3. Nëse QKL-ja konstaton njëri nga shkaqet e refuzimit, ajo vendos refuzimin përfundimtar të kërkesës.
4. Në rast të kundërt, QKL-ja publikon në regjistër vendimin paraprak të kalimit në fazën e dytë të shqyrtimit dhe njofton, në mënyrë elektronike, institucionet e tjera, që shqyrtojnë përmbushjen e një apo të disa kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit, në kompetencë të tyre.
5. Institucionet e tjera, brenda afatit të caktuar, shqyrtojnë përmbushjen e kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit, në kompetencën e tyre duke kryer vlerësimin, inspektimin, duke organizuar testimin apo garën, intervistën apo dëgjimin, ose duke zbatuar metodën tjetër përkatëse dhe shprehin miratimin apo refuzimin e tyre për përmbushjen ose mospërmbushjen e

kritereve përkatëse. Refuzimi parashikon edhe shkaqet e tij. Refuzimi apo miratimi publikohet menjëherë nga vetë institucioni në regjistër.

6. Nëse akti i miratimit apo i refuzimit nga njëri nga institucionet është, paraprakisht, i domosdoshëm për shqyrtimin e të njëjtit kriter apo të një kriteri tjetër licencimi/autorizimi/lejimi nga një institucion tjetër, afati i caktuar për këtë të fundit fillon nga publikimi në regjistër i miratimit apo i refuzimit të institucionit të parë.

7. Afati i caktuar, sipas pikave 5 e 6 të këtij neni, është afati për shqyrtimin e përmbushjes ose jo të kriterit përkatës nga institucioni tjetër dhe përcaktohet nga Këshilli i Ministrave për çdo kategori/nënkategori. Afati fillon të llogaritet nga data e publikimit të vendimit të QKL-së, sipas pikës 4 të këtij neni.

8. Mospublikimi i përgjigjes brenda afateve të përcaktuara në pikën 5 apo 6 të këtij neni, apo kur refuzimi nuk përmban shkakun e refuzimit, vlerësohet si miratim në heshtje i institucionit tjetër.

9. Jo më vonë se 2 ditë nga kalimi i afrit të fundit dhe më të gjatë, sipas pikës 5 apo 6 të këtij neni, QKL-ja merr një vendim përfundimtar për kërkesën e paraqitur.

10. Nëse, qoftë edhe një nga institucionet e tjera ka vendosur refuzimin dhe shkaqet e tij, QKLja vendos refuzimin e kërkesës, në rast të kundër QKL-ja vendos, përkatësisht, miratimin.

III.2.8. Në nenin 30 “Ankimi”, seksioni 5 të ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht:

1. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve të QKL-së apo institucionit tjetër në rastin e grupit të tretë.

2. Ankimi administrativ shqyrtohet nga titullari i QKL-së, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni.

3. Në rastin e refuzimit të parashikuar në pikën 10 të nenit 20 të këtij ligji, ankimi shqyrtohet nga institucioni tjetër, që e ka vendosur refuzimin.

4. Ankimi, në të gjitha rastet, paraqitet me kërkesë në QKL, sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj. Në rastin e parashikuar në pikën 3 të këtij neni, QKL-ja publikon ankimin dhe njofton, në mënyrë elektronike, institucionin tjetër kompetent.

5. Ndaj vendimit të dhënë pas shqyrtimit të ankimit administrativ apo mosveprimit mund të bëhet ankim drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

III.2.9. Në shtojcën e ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, Fusha III “Mjedisi dhe burime mjedisore bazë”, parashikohet shprehimisht:

12 1. Leje Për ndikimin në mjedis.

13 2. Licence Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis.

14 3. *Licence Importi i mbetjeve për qëllim riciklimi, përpunimi, dhe/ose përdorimi ose importi i substancave ozon-holluese.*

III.2.10. Në aneksin 1 të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjetë qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të Përbashkëta”, Fusha III “Mjedisi dhe burime mjedisore bazë”, Kategoria III.2 “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis.”, parashikohet shprehimisht:

1. *Veprimtaria e “shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis ” është kategoria III.2 e shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.*

2. *Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në dy nënkategori si vijon:*

a) *“veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis” me kodin III.2.A;*

b) *“veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, me kodin III.2.B.*

3. *Licencat e kategorisë III.2 jepen pa afat kohor.*

8. *Licencat për nënkategorinë III.2.B jepen për çdo vend ku kryhet veprimtaria.*

9. *Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.*

10. *Kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për kategorinë III.2.B, përcaktohen në tabelën 2 më poshtë.*

11. *Licencimi i nënkategorisë III.2.B bëhet sipas procedurës së grupit III.*

a) *Institucioni tjetër, që verifikon plotësimin e kriterëve të licencimit për nënkategorinë III.2.B është struktura e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave e caktuar me udhëzim të ministrit sipas kompetencës territoriale në vendin ku ushtrohet veprimtaria. Vendimi bazohet në dokumentet provuese dhe në inspektimin në vend për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve përkatëse të licencimit. b) Afati i marrjes së vendimit është 30 ditë.*

IV. DATA E FILLIMIT TË LICENCIMIT SIPAS KËTIJ VENDIMI

12. *Licencimi i veprimtarive sipas këtij vendimi fillon më datë 9.6.2009.*

III.2.11. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.2.12. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë *d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.* Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar se: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë: Liçencë të vlefshme të shoqërisë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL), Kategoria III.2 “ Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis “, Nënkatgoria III.2.B “Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane”.* Referuar proces-verbalit të argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton se autoriteti kontraktor për kriterin e mësipërm ka arsyetuar se: *Kërkesa e mësipërme 2.3.2 është përcaktuar bazuar në pikën 2, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit” Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, pasi liçenca me (kodi III.2.B) është në përputhje me zërat e preventivit të realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike ku kërkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane.* Referuar sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se objekti i prokurimit të procedurës objekt-ankimi është **Shërbim Pastrimi të territorit të Bashkisë Himarë, Njësi Administrative Horë Vranisht dhe Lukovë** dhe autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të paraqesin Liçencë të kategorisë “*Kategoria III.2 “ Shërbime ekspertize dhe/ose*

profesionale lidhur me ndikimin në mjedis “, Nënkatëgoria III.2.B “Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi operatorëve ekonomikë “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, rezulton se operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK ka dorëzuar Licencë e kategorisë “III.2.B (1) LN-1163-03-2016, “Alko Impex General Construction” SHPK, me akt - miratimi Nr. 1531 prot, datë 04.03.2016, me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”. dhe operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK ka dorëzuar Licencë e kategorisë “III.2.B (1) LN-1293-10-2020, “Alko Impex Construction” SHPK, me akt - miratimi Nr. 6758 prot, datë 12.10.2020, me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt prokurimi, i pajisur me licencën përkatëse sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të këtij kriteri bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, rezulton se operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK ka dorëzuar Licencë e kategorisë “III.2.B (1) LN-1163-03-2016, “Alko Impex General Construction” SHPK, me akt - miratimi Nr. 1531 prot, datë 04.03.2016, me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”. dhe operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK ka dorëzuar Licencë e kategorisë “III.2.B (1) LN-1293-10-2020, “Alko Impex Construction” SHPK, me akt - miratimi Nr. 6758 prot, datë 12.10.2020, me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”. Nga shqyrtimi i kriterit të mësipërm, vërejmë se autoriteti kontraktor ka kërkuar në mënyrë eksplicite Licencë të vlefshme të shoqërisë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licënsimit (QKL) Nënkatëgoria III.2.B “Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane”. Sa më sipër, rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë është i licencuar për kategorinë III.2.B ashtu sikurse është kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në këtë kuptim KPP gjykon, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK është në kushtet e përmbushjes së kërkesave në kriterin e veçante të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon Licencës së kategorisë III.2.B të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, pasi nga verifikimet e kryera, konstatohet se Licenca III.2.B (1) LN-1163-03-2016, “Alko Impex General Construction” SHPK, me akt - miratimi Nr. 1531 prot, datë 04.03.2016, me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”. dhe Licenca e kategorisë “III.2.B (1) LN-1293-10-2020, “Alko Impex Construction” SHPK, me akt - miratimi Nr. 6758 prot, datë 12.10.2020, me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”, të lëshuar nga QKL (Sot QKB) për këta operatorë ekonomikë është aktive edhe në momentin e vendimarrjes, verifikuar kjo në Regjistrin e Lejeve dhe Licencave të lëshuar nga QKB, në faqen zyrtare të internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Në këtë mënyrë, vlerësojmë se nuk mund

të shprehim dhe të vlerësojmë nëse një akt administrativ i lëshuar nga një organ tjetër administrativ, i cili nuk ka mardhënie hierarkike me Komisionin e Prokurimit Publik është ose jo në përputhje me legjislacionin sektorial. Gjithashtu, ligji i prokurimit publik, aktet nënligjore në zbatim të tij nuk parashikojnë në asnjë rast kompetencën e KPP-së për t'u shprehur në lidhje me vlefshmërinë e licencave. Vlerësojmë se konstatimet se licencat e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimes “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 “*Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë*”, nuk janë të mbështetur në ligj si edhe janë jashtë kompetencave lëndore të Komisionit të Prokurimit Publik. Në nenin 113 të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se: “*Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.*” Sa më sipër, vlerësojmë se ex ante përpara lidhjes së kontratës operatori ekonomik do të ushtronte veprimtari në kundërshtim me ligjin, atëherë kjo do të duhej të konstatohet nga organi publik i caktuar nga akti nënligjor i cili ka miratuar licencën si edhe nga ana tjetër nuk do të çenohej interesi publik, i lidhjes së kontratës me një operator ekonomik i cili nuk disponon kapacitetet ligjore/ teknike të nevojshëm.

Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor për papajtueshmërinë e drejtuesit teknik Komisioni Prokurimit Publik për një shqyrtim të drejtë të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes, gjykon ti drejtohet për interpretim parashikimeve ligjore të legjislacionit sektorial, dhe konkretisht, aktit nënligjor në zbatim të ligjit, ku në kreun IV “Drejtuesi teknik dhe pa pajtueshmëria me këtë detyrë” të Vendimit nr. 42 datë 16.01.2008 të Këshillit të Ministrave “*Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi*”, i ndryshuar parashikohet se: “*2. Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punëmarrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit*”. Referuar parashikimit të mësipërm ligjor, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se rregullat e posaçëm të cilët parashikojnë njëherazi edhe procedurën e licencimit të shoqërive në ndërtim strictu senso, parashikojnë ndalime strikte të dy punësimit të drejtuesve teknik të shoqërisë veçanërisht ato të punësimit të tyre në subjekte private dhe njëherazi në institucione publike. Rregullimi i mësipërm është parashikuar në kreun i cili parashikon edhe kushtet e papajtueshmërisë së detyrës së drejtuesit teknik të shoqërive që *Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi*. Ndërkohë në rastin konkret objekt shqyrtimi nuk ndodhemi përpara faktit të licensimit të operatorëve ekonomik ankimes sipas VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 e cila fushën e veprimtarisë e ka për shoqëritë që *Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi*. Pasi objekti prokurimit për të cilën KPP është venë në lëvizje për të shyrtuar ankesën lidhet me shërbim pastrimi dhe vetë autoriteti kontraktor në proceverbalin e argumentimit të kriterëve ka përcaktuar aktet ligjore dhe nënligjore si më poshtë: Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçencë të vlefshme të shoqërisë e lëshuar

nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) , Kategoria III.2 “ Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis “, Nënkatgoria III.2.B “Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane”. Kërkesa e mësipërme 2.3.2 është përcaktuar bazuar në piken 2, te nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” dhe nenin 41, pika 4, gërma a.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit” Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, pasi liçenca me (kodi III.2.B) është në përputhje me zërat e preventivit të realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike ku kërkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane.

III.2.13. Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale, si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht nenin 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 36 “Sigurimi i kontratës”, dhe nenin 108 “Raportimi në rastet e mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, si dhe nenit 36 “Sigurimi i kontratës”, dhe nenit 108 “Raportimi në rastet e mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar. Bashkimi operatorëve ekonomikë ankimes “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK me anë të dokumentacionit të paraqitur, vërteton se plotëson me sukses kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes BOE “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues BOE “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK, mbi skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: *“Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të ofertave ka konstatuar se : Nga ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D, Znj. A. F, është administratore e kesaj shoqërie që nga data 05/05/2020 deri më: 05/05/2025. Fakti që Znj. A. F nuk është e deklaruar në listëpagesa për një periudhë mbi 6 muaj, përmban shkelje të legjislacionit në fuqi: ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Bazuar në nenin 77, pika 3, gërma “ a ” të ligjit nr. 162/ 2020 “Për prokurimin publik” , çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është pale. Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALKOIMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D., rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në dokumentet e tenderit kërkesa për licencë, gjë e cila do të përbënte detyrim për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë nëse do të kërkoheshin në DT.*

Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit cenon parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues BOE “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues BOE “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK, mbi skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: *“Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të ofertave ka konstatuar se : “Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të ofertave ka konstatuar se : Formulari i Vetëdeklarimit të “ ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D, përban gabime sepse deklarimi fillon në emër të “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj..... Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos të refuzojë*

ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALKOIMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, në Shtojcën 9 në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- -
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Shërbimet /Mallrat e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat,tatimet dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p>

<p>e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

përfshijtur nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	
---	--

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklaratë;	Po []
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po []
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po []
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit	Po []

<p>paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;</p>	
<p>5. Për efekt të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:</p> <p>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;</p> <p>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës.</p>	<p>Po []</p>
<p>6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e</p>	<p>Po [] Jo []</p>

<p>kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).</p>	
<p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave,</p>	<p>Po [] Jo []</p>

shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.	
---	--

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p> <p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. <p>Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të</p>

institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e	Po [] Jo []

diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	
2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.	Po [] Jo []
3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	Po [] Jo []

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me	Po [] Jo []

Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p>Data e dorëzimit të deklaratës _____ Vula _____</p> <p>Emri, Mbiemri, Firma _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.

- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, **një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit** duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër. Shënim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik BOE “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK., në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit (shtojca 8) dorëzuar në SPE.

III.4.3. Në nenin 77, pikën 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.4.4. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.4.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash

6. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.4.6. Vendosja e kriterëve të kualifikimit, ka si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Pra, kriteret e përgjithshme të kualifikimit duhet të përmbushen, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës

të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8). Autoriteti kontraktor ka skualifikuar këtë operator ekonomik me arsyetimin: *“Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të ofertave ka konstatuar se : Formulari i Vetëdeklarimit të “ ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D, përban gabime sepse deklarimi fillon në emër të “ALKO-IMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj..... Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALKOIMPEX General Construcion” Degë e shoqërisë së huaj me Nuis: K91326028I & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK me Nuis: K91628013D. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues në dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme, për rastet kur të dhënat janë të aksesueshme në mënyrë elektronike nga autoriteti kontraktor, siç parashikohet në dispozitat e sipërcituara në fushën e prokurimit publik. Në çdo rast AK mund ti kërkonte sqarime operatorit ekonomik për paqartësi apo verifikime mbi dokumentin në përputhje me neni 82 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”:*

“Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.”

Referuar Formularit të Vetëdeklarimit të plotësuar nga OE dorëzuar SPE nga BOE “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK, vërehet se janë plotësuar në mënyrë korrekte të gjitha fushat e kërkuara në formular, si edhe është plotësuar pjesa e fundit e formularit ku kërkohet data e dorëzimit, emri, mbiemri, firma si edhe vula e shoqërisë.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues BOE “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK, mbi skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: *“Operatori ekonomik “ REJ “ SHPK me Nuis: Nuis: J93711608Q, nuk plotëson kriterin 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë: 1 (një) punonjës të licencuar si “Ekspert Dhënie e Ndhmës së Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme: - Liçencë; - CV-në përkatëse; -*

Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme). Znj E. XH disponon çertifikim vetëm për dhënien e ndihmës së pare, dhe jo për ndërhyrjen ndaj emergjencave., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, në Shtojcën 9 në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatorit ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- -
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Shërbimet /Mallrat e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

<p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat,tatimet dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p>

<p>e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

përfshijtur nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	
---	--

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
11. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklaratë;	Po []
12. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po []
13. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po []
14. Çdo person, nënshkrimi i të cilit	Po []

<p>paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;</p>	
<p>15. Për efekt të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:</p> <p>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;</p> <p>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës.</p>	<p>Po []</p>
<p>16. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>17. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e</p>	<p>Po [] Jo []</p>

<p>kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).</p>	
<p>18. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>19. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>20. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave,</p>	<p>Po [] Jo []</p>

shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.	
---	--

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p> <p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. <p>Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të</p>

institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
4. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e	Po [] Jo []

diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	
5. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.	Po [] Jo []
6. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	Po [] Jo []

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me	Po [] Jo []

Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p>Data e dorëzimit të deklaratës _____ Vula _____</p> <p>Emri, Mbiemri, Firma _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.

- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, **një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit** duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër. Shënim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.5.2 . Në shtojcën 8/2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshtë vijon:

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga administratori i shoqërisë, Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit për **objektin e marrëveshjes kuadër/kontratës**, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Diplomë;
- b) CV përkatëse;
- c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- *1 (një) Inxhinier Mjedisi ose 1 (Ekspert në fushën e Mjedisit), shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:*

- a) *Diplomë;*
- b) *CV-në përkatëse;*
- c) *Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).*

- *1 (një) punonjës të licencuar si “Kordinator i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:*

- a) *Liçencë;*
- b) *CV-në përkatëse;*
- c) *Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).*

- 1 (një) punonjës të licencuar si “Ekspert Dhënie e Ndihmës së Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- d) Liçencë;
- e) CV-në përkatëse;
- f) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara fazës së nënshkrimit të kontratës duhet t’i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

III.5.3. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Rej” SHPK në përmbushje të kritereve sa më sipër, për sa i përket një punonjës të licencuar si “Ekspert Dhënie e Ndihmës së Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”, ka paraqitur të plotësuar shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, sipas të cilës shoqëria “Rej” SHPK deklaroi punonjësit si vijon:

- Znj. E. XH, me profesion Inxhinierë ndërtimi, e punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Ekspertit Dhënie e Ndihmës së parë dhe Ndërhyrje ndaj Emergjencave dhe e Licensuar si eksperte Ekspert Dhënie e Ndihmës së parë dhe Ndërhurjen ndaj Emergjencave.

Për punonjësën e sipërcituar, operatori ekonomik “Rej” SHPK, ka paraqitur dokumentacionin përkatës, që vërteton disponimin e tyre, siç kërkohet në dokumentet e tenderit.

III.5.4. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.5.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.5.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, rezulton se në dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar 1 (një) punonjës *1 (një) punonjës të licencuar si “Ekspert Dhënie e Ndihmës së Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”*, për të cilët duhet të paraqitet Liçencë; CV-në përkatëse; Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme). *Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjesit në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.* Rezulton, se operatori ekonomik “Rej” SHPK ka deklaruar në ofertën e tij, nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9, se ka të punësuar Znj E. XH, me profesion *Ekspert Dhënie e Ndihmës së Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave.* Përveç vetëdeklarimit në ofertë është paraqitur edhe dokumentacioni që

vërtetohet se punonjësi është e punësuar pranë kësaj shoqërie. Konkretisht: për Znj E. XH është paraqitur kontrata e punës, e lidhur në datën 01.01.2021 me shoqërinë “Rej” SHPK për një afat të pa caktuar, për të punuar në pozicionin e *Ekspert Dhënie e Ndhmës së Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave*, dokumenti që vërtetohet përfundimin e Universitetit, si dhe licencë/certifikatë Nr. 0005711, lëshuar nga Kryqi i Kuq Shqiptarë. Për sa më sipër cituar, duke qenë se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatori ekonomik zotëron personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës objekt-shqyrtimi, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Rej” SHPK provon, se i ka të punësuar një punonjës *Ekspert Dhënie e Ndhmës së Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave*, në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor si më sipër cituar.

III.5.7. Referuar sa më sipër KPP vëren se autoriteti kontraktor ka kërkuar disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të një stafi prej 40 personash nga të cilët një *Ekspert Dhënie e Ndhmës së Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave*. Autoriteti kontraktor ka kërkuar gjithashtu dokumentacion për provueshmërinë e stafit sic është kontrata pune, Licenca dhe CV. Ndërkohë autoriteti kontraktor ka nënvizuar se në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore *Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike..* Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi për përmbushjen e kriterit lidhur me një *Ekspert Dhënie e Ndhmës së Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave*. KPP vëren se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike deklartën e stafit të cilin ka deklaruar një punonjës me profil *Ekspert Dhënie e Ndhmës së Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave*. KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin lidhur me punonjësit e kërkuar në përputhje me kërkesat në kriterin e vecantë të kualifikimit. Kështu autoriteti kontraktor ka theksuar se për përmbushjen e kriterit në fazën e vlerësimit ofertuesit do të duhet të paraqesin deklartatën e stafit ndërsa në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale të punës si dhe diplomat e cdo punonjësi prane AK jo më vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor nuk rezulton që autoriteti kontraktor të ketë kërkuar dokumentacionin e punonjësve nga ana e operatorit ekonomik ankimues. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka skualifikuar operatorin ekonomik Rej shpk me argumenta të pabazuara dhe në tejkalim të kriterit të vecantë të kualifikimit. Në këtë kuptim KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin lidhur me punonjësit sanitarë në përputhje me kriterin e kualifikimit.

Gjithashtu, sipas shtojcës 12 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Pjesa II, Pika A-Deklarata për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit, është përcaktuar që referencat për këto lloj deklaratah do të bëhen në rastet kur janë të zbatueshme: “Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni”. Pra, Komisioni gjykon, se ka dy mënyra se si autoriteti kontraktor mund të marrë këto dokumente, e para në bazë të të dhënave të aksesueshme shtetërore nëse është i disponueshëm dhe e dyta duke **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.** Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit, duhet t’i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor dhe kërkesën për **dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.** Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti kontraktor ai që duhet t’i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë. KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik në rastin konkret, nuk është në përputhje me kriterin e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor për plotësimin e këtij kapaciteti, pasi nga shqyrtimi dokumentacionit dhe informacionit të ardhur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, nuk rezulton që ky i fundit të këtë bërë një hetim apo verifikim për mjetet. Për më tepër, KPP vëren, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi

thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet t’i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimit e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285**, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me arsyetimin se: “Autoboti AA865GC nuk është i pajisur me me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, sipas kërkesave të dokumenteve standarte të tenderit. a) Makina me vinc për ngarkim-shkarkim kazanesh gjate levizjes dhe sharkimit ne vendet e perdorimit, jo më pak se 1 (nje) copë; Automjeti me targa AB480CC, nuk është vinç për ngarkim-shkarkim kazanesh.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

<i>Identifikimi</i>	<i>Përgjigja</i>
<i>Emri i operatorit ekonomik:</i> <i>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)</i>	-----
<i>Numri NIPT/et:</i>	-----
<i>Adresa postare:</i> <i>Qyteti / qyteti; Kodi postar</i>	-----
<i>Përfaqësuesi (emri):</i>	-----
<i>Telefoni:</i>	-----
<i>E-mail:</i>	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- ***Informacione për nënkontraktorin***

<i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i>	<i>NIPT –i</i>	<i>Përqindja e nënkontraktimit</i>	<i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar</i>

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

<i>Deklarata</i>	<i>Referencat (kur janë të zbatueshme)</i>
<i>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</i>	<i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i>

<p><i>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</i></p>	<p><i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</i></p> <p><i>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i></p>
<p><i>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</i></p> <hr/> <hr/> <p><i>etj.</i></p> <p><i>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</i></p>	<p><i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</i></p> <p><i>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</i></p>	<p><i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</i></p> <p><i>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</i></p> <p><i>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</i></p>

	<i>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i>
<i>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</i>	<i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i>
<i>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</i>	<i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i>
<i>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i>	<i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i>
<i>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</i>	<i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i>
<i>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar</i>	<i>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</i>

<p><i>ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</i></p>	
---	--

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
<p><i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</i></p>	
<p><i>21. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklaratë;</i></p>	Po []
<p><i>22. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;</i></p>	Po []
<p><i>23. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;</i></p>	Po []

<p>24. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;</p>	<p>Po []</p>
<p>25. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:</p> <p>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;</p> <p>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .</p>	<p>Po []</p>
<p>26. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>27. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes</p>	<p>Po [] Jo []</p>

<p><i>ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit).</i></p>	
<p>28. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>29. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>30. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [] Jo []</p>

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijsëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrot, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me

bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005.

*Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.***

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:</i>	
<i>7. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.</i>	<i>Po [] Jo []</i>
<i>8. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në</i>	<i>Po [] Jo []</i>

<i>veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.</i>	
<i>9. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.</i>	<i>Po [] Jo []</i>

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.</i>	<i>Po [] Jo []</i>

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>

<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p>Data e dorëzimit të deklaratës _____ Vula _____</p> <p>Emri, Mbiemri, Firma _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një **Formular të veçantë të Vetëdeklarimit**.
- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një **Formular i veçantë i Vetëdeklarimit** duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

Shenim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.6.2. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi të modifikuara përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, **ku të përcaktohet tipi (emertimi teknik), lloji, marka, nr. i shasisë, viti i prodhimit dhe sasi të përkatëse për mjetet si me mëposhtë:**

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton, jo më pak se **2 (dy) copë. (një rezervë)**
- b) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më shumë se 8 ton, jo më pak se **1 (nje) copë;**
- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më shumë se 5 ton, jo më pak se **1 (nje) copë;**
- c) Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues jo me pak se 3.5 ton, jo më pak se **1 (nje) copë;**
- d) Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 7-8 mijë litra ujë, jo më pak se **1 (një) copë;**
- e) Makina me vinc për ngarkim-shkarkim kazanesh gjate levizjes dhe sharkimit ne vendet e perdorimit, jo më pak se **1 (nje) copë;**
- f) Të paraqiten mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë: Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë, jeleke per veshje te te punesuaeve 20 cope dhe mushama shiu trupore 20 cope; .

Për mjetet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Për mjetet e deklaruara në pronësi qe shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) ,leje qarkullimi , çertifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.
- Per mjetet e deklaruara me qera qe shënohen në regjistra publike duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse noteriale te qirasë, dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) , leje qarkullimi , çertifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.
- Kontrata e qerasë duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, të cilat deklarohen në pronësi, operatori ekonomik, duhet të paraqese kontraten e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe

dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.

- Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit te porositur(emertimin teknik),llojin,marken,nr. e shasise,vitin e prodhimit, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur.
- Per mjetet e paregjistruara ne Republiken e Shqiperise, paraqitet marreveshje paraprake e shitblerje sipas njerit prej rasteve ne vijim, me pronarin e automjeteve.
- (ii) me koncesionarin ose ndermjetesin ne rastin kur ka periudhe tranzitore per te pasur te drejten e posedimit te mjeteve.

(iii)me prodhuesin ose koncesionarin ne rastin e paraqitjes ne proceduren e prokurimit me mjete te reja.

Ne te gjitha rastet subjekti duhet te paraqese dokumentacionin e nevojshem i cili verteton se subjekti qe merr persiper furnizimin e mjeteve ka sipas dokumentacionit te vendit te origjines, te drejten per te pasur ne pronesi ose gezuar te drejten e shitblerjes se mjeteve te paraqitura.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Për mjetet në pronësi/qera apo të porositura, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 14 (katërm dhjetë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit për të cilën është shpallur Fitues, si dhe te deklarojë adresen e sakte te vendndodhjes se mjeteve në Shqipëri, me qellim verifikimin e tyre. Në rast se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon mjetet brenda afatit të sipërcituar, ai do të s’kualifikohet, dhe Autoriteti Kontraktor do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.

III.6.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Rej” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Deklaratë për verifikimin fizik të mjeteve.
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 9) nga operatori ekonomik “Rej” SHPK, ku në Deklaratën B për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme është plotësuar si vijon:

III.6.4. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.6.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. **Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.**

III.6.6. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.6.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa**

vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarinimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqiturnë procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.6.8. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë

zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[...]”

III.6.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: **“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve standarde të tenderit të modifikuara për disponimin e 6 (gjashtë) mjeteve teknologjike të tipologjive të ndryshme në pronësi/përdorim/qira, për shërbimin e pastrimit, operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), **1- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 9),**

2- Dokumentacion për mjetet ndër të tjera edhe për Mjetin me Targë AA480CC, Leje Qarkullimi, Certifikatë Pronësie, Certifikatë e kontrrolit Teknik, Policë Sigurimi dhe Taksat. Targa AB 865 GC, Leje Qarkullimi, Certifikatë Pronësie, Certifikatë e kontrrolit Teknik, Policë Sigurimi. 3- Deklaratë për verifikimin e mjeteve. Autoriteti kontraktor ka skualifikuar këtë operator ekonomik me arsyetimin se Autoboti AA865GC nuk është i pajisur me me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, sipas kërkesave të dokumenteve standarte të tenderit. Automjeti me targa AB480CC, nuk është vinç për ngarkim-shkarkim kazanesh. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues në dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës konkretisht ka deklaruar mjetet në shtojcën përkatëse, ka ngarkuar në SPE, dhe deklaratën sipas përcaktimit të pikës 2.3.5 të dokumenteve standarde të tenderit në lidhje me përmbushjen e kriterit mbi disponimin e mjeteve të kërkuara për realizimin me sukses të procedurës objekt-shqyrtimi. Për më tepër, autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit për këtë procedurë prokurimi dhe përpara publikimit të njoftim-fituesit nuk ka zbatuar përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 26 të VKM, ku thuhet se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.** Gjithashtu nuk ka kërkuar asnjë sqarim apo informacion në përputhje me pikën 7 të nenit 26 të VKM, sipas së cilës në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Në rastin konkret autoriteti kontraktor nuk i ka kërkuar ofertuesit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2 shkronjën i) *operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti, për arritjen e një përfundimi të saktë, që operatori ekonomik ankimues nuk e plotëson këtë kriter.*

Gjithashtu, sipas shtojcës 12 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Pjesa II, Pika A-Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, është përcaktuar që referencat për këto lloj deklaratash do të bëhen në rastet kur janë të zbatueshme: “Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni”. Pra, Komisioni gjykon, se ka dy mënyra se si autoriteti kontraktor mund të marrë këto dokumente, e para në bazë të të dhënave të aksesueshme shtetërore nëse është i disponueshëm dhe e dyta duke **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.** Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, duhet t'i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga

autoriteti kontraktor dhe kërkesën për **dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.** Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti kontraktor ai që duhet t’i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë. KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik në rastin konkret, nuk është në përputhje me kriterin e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor për plotësimin e këtij kapaciteti, pasi nga shqyrtimi dokumentacionit dhe informacionit të ardhur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, nuk rezulton që ky i fundit të këtë bërë një hetim apo verifikim për mjetet. Për më tepër, KPP vëren, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet t’i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285,** si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me

originalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Rej” sh.p.k. mbi kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomik BOE “AEK & CO & Pastrime Silvio” SHPK., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorëve për të cilët paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.

Sa mësipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Rej” sh.p.k., mbi ofertat e bashkimit të operatorëve ekonomik BOE “AEK & CO & Pastrime Silvio” SHPK., nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi operatorëve ekonomikë “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-20775-02-28-2022, me objekt “Marrëveshje kuadër me kohëzgjatje 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj: “ Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë”, me Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 289 674 042 (dy qind e tetëdhjetë e nëntë milion e gjashtë qind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyzet e dy) lekë pa TVSH ose 2,389,458.40 (dy milion e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katër qind e pesëdhjetë e tetë presje dyzet) EURO. (Kursi i këmbimit 121,23), **Loti 2** me Nr. REF-20782-02-28-2022, me objekt “Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë, Njësia Administrative Horë- Vranisht dhe Lukovë” me fond limit është 119 700 663 (një qind e nëntëmbëdhjetë milion e shtatë qind mijë e gjashtë qind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH ose 987,384.83 (nëntë qind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tre qind e

tetëdhjetë e katër presje tetëdhjetë e tre) EURO. (Kursi i këmbimit 121,23), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 01.04.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himar.

2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK për procedurën e prokurimit më sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK, dhe operatorit ekonomik “Rej” SHPK si dhe të korrigojë shkeljet duke i kualifikuar këta operatorë ekonomikë.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alko Impex General Construction” dshh & “Alko Impex Construction” SHPK, dhe operatorit ekonomik “Rej” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri